



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**BASHKIA KORÇË**

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT  
DHE MENAXHIMIT TË KONTRATAVE TË INFRASTRUKTURËS**

**SPECIFIKIME TEKNIKE**

**Rehabilitim i Qendrës Rinore, Korçë**



## **SPECIFIKIME TEKNIKE**

### **Seksioni 1- Punime prishje.**

### **Seksioni 2- Transport materiale ndertimi.**

### **Seksioni 3- Punime murature tulle.**

-3.1 Punime murature tulle.

-3.2 Ndertim muri me gips.

### **Seksioni 4- Nenshtresa dhe shtresa ne territorin e ndertesave.**

-4.1 Shtres me pllaka grez.

-4.2 Heqje pllaka betoni trotuari ekzistues.

### **Seksioni 5- Punime dyer dritare.**

-5.1 Dyer d\alumini tek xham.

-5.2 Dritare d\alumini tek xham.

-5.3 F.V dritare d\alumini plastike me dopjo xham.

-5.4 Heqje dritare ekzistuese.

-5.5 Heqje parmake metalike.

### **Seksioni 6-Punime bojatisje**

-6.1 Boje hidroplastike.

-6.2 Parapet shkalle me tuba inoksi h=80-90cm.

-6.3 Boje hidroplastike cilesi e larte.

-6.4 Boje vaji siperfaqe metalike.

### **Seksioni 7- Punime tavani dhe suvatimi.**

-7.1 Veshje me pllake majolike.

-7.2 Plintuese grez h=10cm.

-7.3 Patinim muri allci(stuko).

-7.4 Veshje fasade me polisterol.

### **Seksioni 8- Punime shtresash .**

-8.1 Shtrese lluster cemento 1:2.

-8.2 Shkalle montazhi mermer.

### **Seksioni 9- Instalime hidrosanitare.**

-9.1 F.V bolier 100L.

### **Seksioni 10- Instalime per ndricim.**

- 10.1 F.V Prize shuko universal
- 10.2 F.V Celes 1 polar 220V 10A.
- 10.3 F.V Ndricules fluoreshent.
- 10.4 F.V Ndricules tip spot me llampa fluoreshente.
- 10.5 F.V Tub plastmasi 18-21mm

### **Seksioni 11-Punime hidroizolimi dhe catite.**

- 11.1 Ulluk shkarkimi horizontal me PVC 33cm.
- 11.2 Ulluk vertical shkarkimi me PVC 120mm.

### **Seksioni 12-Analiza jashte liste.**

- 12.1 F.V kabell 0.6kV 3x2.5mm<sup>2</sup>.
- 12.2 F.V kabell 0.6kV 3x1.5mm<sup>2</sup>.
- 12.3 F.V pllaka guri +obor shkalle.

### **Seksioni 13- Pajisje jashte liste.**

- 13.1 Raketa ping pong.
- 13.2 Top ping pong.
- 13.3 Tavoline bilardo.
- 13.4 Steka bilardo.
- 13.5 Tavoline futbolli(bilardino).
- 13.6 Kavalet picture.
- 13.7 Ndenjese puff.
- 13.8 Ndenjese statike.
- 13.9 Tavoline mbledhjesh.
- 14 Mobilje me dollap(Komodine zyre).
- 14.1 Tavoline me syprine trekendeshi.
- 14.2 Kolltuke kinemaje lounge.
- 14.3 Ekran kinemaje.
- 14.4 Kompjuter njesi.
- 14.5 Ekran kompjuteri.

- 14.6 Mouse kompjuteri.
- 14.7 Tastiere kompjuteri.
- 14.8 Sistem audio kinemaje.
- 14.9 Pasqyra murale.
- 15 Mikrofon podcast.
- 15.1 Kufje.
- 15.2 Varrese rrobash e mberthyer ne mure.

## SPECIFIKIME TEKNIKE

### 1. Prishja e mureve të tullës

Prishje e muraturës me tulla të plota ose me vrima, e çfarëdo lloji dhe dimensionit, edhe e suvatuar ose e veshur me majolikë, që realizohet me çfarëdo lloji mjeti dhe e çfarëdo lartësie ose thellësie, përfshirë skelën e shërbimit ose skelerinë, armaturat e mundshme për të mbështetur ose mbrojtur strukturat ose ndërtesat përreth, riparimi për dëmet e shkaktuara ndaj të tretëve për ndërprerjet dhe restaurimin normal të tubacioneve publike dhe private (kanalet e ujrave të zeza, ujin, dritat etj..), si dhe vënien mënjandë dhe pastrimin e gurëve për përdorim, duke bërë sistemimin brenda ambientit të kantierit. Gjithashtu, edhe çdo detyrim tjetër që siguron plotësisht prishjen.

### 2. Transport material

Transporti dhe magazinimi i materialeve Transporti i çdo materiali nga Sipermarresi do të bëhet me makina të pershtateshme të cilat kur ngarkohen nuk shkaktojnë derdhje dhe e gjithë ngarkesa të jete e siguruar. Ndonje makine që nuk plotëson këto kërkesë ose ndonje nga rregullat ose ligjet e qarkullimit do të hiqet nga kantieri. Të gjitha materialet që sillen nga Sipermarresi, duhet të stivohen ose të magazinohen në menyre të pershtateshme për të mbrojtur nga rreshqitjet, demtimet, thyerjet, vjedhjet dhe në dispozicion, për tu kontrolluar nga Mbikqyresit i Punimeve në çdo kohë.

### 3. Punime murature tulle.

#### 3.1 Mur i brendshëm me tulla me birra 20 cm.

Muraturë me tulla me 6 brima, me trashësi 20 cm realizuar me llaç bastard m-25 sipas pikës 5.1.1 me përmbajtje për m<sup>3</sup>: tulla me 6 vrima, llaç 0,12 m<sup>3</sup>, çimento 400 dhe ujë, përfshirë çdo detaj e kërkesë për dhëmbët e lidhjes, qoshet, hapjet në parapetet e dritareve, skelave të shërbimit ose skelerinë si dhe çdo gjë tjetër të nevojshme për mbarimin e muraturës dhe realizimin e saj. Për muraturën e katit përdhe sipërfaqja e xokulit duhet të jetë e niveluar me një Shtrese Llaçi çimento

1:2 me trashësi, jo më të vogël se 2 cm.

### 3.2. Ndertim muri me gips.

Mure gipsi me 2 pllaka te thjeshta Muret e brendshme do te behen prej gipsi me tek strukture, me dopio panel te thjeshte nga secila ane. Pasi eshte vendosur biadeziv ne profi let UD, ata montohen ne solete pastaj ne tavan me UPA. Me pas fillon vendosja e profi leve CD dhe behet shperndarja e tyre. Pas shperndarjes, pickohen ato lart dhe poshte. Fillon vendosja e pllakes se pare me gips te zakonshem krahe dhe fugat mbushen thjesht me llaçin perkates. Pastaj vazhdon vendosja e panelit te dyte me gips te zakonshem, duke u kujdesur qe fugat te mos bien mbi njera tjetren ne po te njejten ane. Pasi jemi siguruar qe kane mbaruar te gjitha instalimet perkatese, fillon vendosja e pllakes se pare po te gipsit te thjesht duke ngjitur, me silikonin perkates te furnizuar nga e njejta fi rme qe furnizon edhe pllakat, pllaken ne vazhdim. Pastaj vazhdon vendosja e shtreses se dyte te paneleve me gips te thjeshte, te cilat ngjiten po me te njejtin silikon. E leme silikonin te thahet per 24 ore, dhe mbushjen e fugave dhe te kokave te vidave i bejme me llaçin perkates kunder lageshtires.

## 4. Shtresa dhe nenshtresa ne territorin e ndertesave.

### 4.1 Dysheme me pllaka gres

Klasifikimi i pllakave bëhet sipas këtyre kriterëve:

- Mënyra e dhënies së formës të pllakës
- Marrja e ujit
- Dimensionet e pllakave
- Vetitë e sipërfaqes
- Veçoritë kimike
- Veçoritë fizike
- Siguria kundër ngricës
- Peshë/ngarkesa e sipërfaqes
- Koeficienti i rrëshqitjes

Tabelat e mëposhtme përshkruajnë disa prej këtyre kriterëve.

Pllakat duhen zgjedhur për secilin ambient, duke marrë parasysh nevojat dhe kriteret, që ato duhet t'i përmbushin. Kriteret dhe tabelat e lartpërmendura mund të ndihmojnë në zgjedhjen e tyre.

II a	$3 \% < E < 6 \%$
II b	$6 \% < E < 10 \%$
III	$E > 10 \%$

Klasat e kërkesave/ngarkimit		
Klasa	Ngarkesa	Zona e përdorimit, psh
I	shumë lehtë	Dhoma fjetëse, Banjo
II	e lehtë	Dhoma banuese përveç kuzhinës dhe paradhomës
III	e mesme	Dhoma banuese, ballkone, banjo hotelesh
IV	rëndë	Zyra, paradhoma, dyqane
V	shumë e rëndë	Gastronomi, ndërtesa publike

Për shkolla dhe kopshte, duhet që pllakat të jenë të Klasës V , me sipërfaqe të ashpër, në mënyrë që të sigurojnë një ecje të sigurtë pa rrëshqitje.

Në ambientet me lagështirë (ËC, banjo e dushe) duhet të vendosen pllaka të klasës I, që e kanë koeficientin e marrjes së ujit  $< 3 \%$ .

Për këtë duhet që përpara fillimit të punës, kontraktori të paraqesë tek Supervizori disa shembuj pllakash, së bashku me certifikatën e tyre të prodhimit dhe vetëm pas aprovimit nga ana e tij për shtrimin e tyre, sipas kushteve teknike dhe rekomandimeve të dhëna nga prodhuesi.

#### 4.2 Heqje pllaka trotuari ekzistues

Bordura betoni për trotuarë Trotuarët, rrugët si dhe pjesët e tjera të shtruara prej asfalti, pllakave të betonit ose prej ndonjë materiali tjetër duhet që të mbrohen në atë mënyrë, që anëve t'u vendoset nga një mbështetëse. Bordura mbështetëse duhet të plotësojë kërkesat e lartëpërmendura për të mbajtur sipërfaqen e shtruar prej forcave horizontale, të cilat shkaktohen nga lëvizja e forcave vertikale, prej makinave, njerëzve, etj. Një funksion tjetër që u shtohet atyre, është që të drejtojnë ujrat e rrugës. Bordurat mund të vendosen në të njëjtën lartësi me sipërfaqen e shtruar ose të jenë nga 10 cm deri në 30 cm më lartë nga rruga sipas nevojës. Materiali i bordurave duhet të jetë prej betoni ose prej guri. Zgjedhja e tij duhet bërë nga arkitekti/Supervizori së bashku me klientin dhe duhet pasur parasysh se materiali i zgjedhur luan një rol të veçantë në dekorimin e sipërfaqeve. Materialet që i ofron tregu janë të këtij lloji: Bordura betoni për trotuarë Trotuarët, rrugët si dhe pjesët e tjera të shtruara prej asfalti, pllakave të betonit ose prej ndonjë materiali tjetër duhet që të mbrohen në atë mënyrë, që anëve t'u vendoset nga një mbështetëse. Bordura mbështetëse duhet të plotësojë kërkesat e lartëpërmendura për të mbajtur sipërfaqen e shtruar prej forcave horizontale, të cilat shkaktohen nga lëvizja e forcave vertikale, prej makinave, njerëzve, etj. Një funksion tjetër që u shtohet atyre, është që të drejtojnë ujrat e rrugës. Bordurat mund të vendosen në të njëjtën lartësi me sipërfaqen e shtruar ose të jenë nga 10 cm deri në 30 cm më lartë nga rruga

sipas nevojës. Materiali i bordurave duhet të jetë prej betoni ose prej guri. Zgjedhja e tij duhet bërë nga arkitekti/Supervizori së bashku me klientin dhe duhet pasur parasysh se materiali i zgjedhur luan një rol të veçantë në dekorimin e sipërfaqeve. Materialet që i ofron tregu janë të këtij lloji:

Bordura prej betoni në dimensionet e ndryshme. Ata janë pjesë të parapërgatitura prej betoni dhe duhet të instalohen sipas mënyrës së përshkruar më poshtë. Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur disa lloje të bordurave prej betoni me karakteristikat e tyre.

Nr.	Bordurat në cm (gjatësi/trashësi/lartësi)	Pesha kg/Stk	Nevoj a për 1 m
1	Përmasat 100/8/20	36	1
	Përmasat 1/3 e gurit 33/8/ 20	12	3
2	Përmasat 100/10/20	46	1
	Përmasat 1/3 e gurit 33/10/ 20	15	3
3	Përmasat 100/12/20	50	1
	Përmasat 1/3 e gurit 33/12/20	17	3
4	Përmasat 100/18/20	80	1
	Përmasat 1/3 e gurit 33/18/20	26	3
5	Përmasat 100/18/25	95	1
	Përmasat 1/3 e gurit 33/18/25	31	3
6	Përmasat 100/20/15	64	1
	Përmasat 1/3 e gurit 33/20/15	21	3

Një lloj tjetër guri që mund të përdoret në të njëjtën mënyrë si bordurat e lartpërmendura, janë tipi i „gurë bordurave“ prej betoni. Me ata mund të realizohen kthesa e harqe të ndryshme.

Në fotografinë e mëposhtme janë paraqitur dy lloje të atij tipi. Montimi i tyre bëhet në të njëjtën mënyrë si bordurat e betonit të lartpërmendur.



**Gurë bordurë**

Format 120 x 180 mm  
Lartësia 600 mm, 800mm,  
1000 mm 1300 mm



**Gurë bordurë**

Format 120 x 120 mm  
Lartësia 400 mm

Të njëjtat bordura që janë të lartpërmendura ekzistojnë edhe prej guri sipas granitit. Ata i plotësojnë të njëjtat funksione si bordurat prej betoni. Dimensionet e atyre varen prej tregut ofrues dhe duhet pyetur. Por si zakonisht ata i kane pothuajse të njëjtat domensione si ata prej betoni.

Montimi i bordurave bëhet në këtë mënyrë:

Bordurat duhet të vendosen para se te bëhet shtrimi i sipërfaqes. Për të bërë atë



duhet hapur një kanal në dhe me dimensionet sipas nevojës. Kanali duhet të jetë të paktën në secilën anë nga 10 cm më i madh se bordurat. Në atë futet beton i thatë (i lagur pakë) dhe bordurat vendosen mbi atë. Nevoja e betonit është rreth 0,05 m<sup>3</sup> beton. Në secilën anë të bordurave duhet vendosur beton në atë mënyrë që ai të fiksohet mirë dhe fortë.

## 5.Punime dyer dritare.

### 5.1Dyer d\alumini tek xham.

F.V. dyer duralumini tek xham

Furnizimi dhe vendosja e dyerve dimensionet e të cilave do të merren nga Kontraktuesi, përbëhen nga:

- Kornizat e dyerve të cilat fiksohen në mur
- Vendosja e dyerve kryhet pas përfundimit të suvatimit dhe lysterjes
- Dyert duhet të kenë brava metalike dhe të shoqërohen me tre kopje çelsash
- Përmbushja e të gjitha kërkesave për përfundimin e punimeve në mënyrën më të mirë
- Mostrat duhet të marrin paraprakisht aprovimin e Supervizorit të punimeve

### 5.2 F. V. dritare d\alumini tek xham

Dritaret janë pjesë e rëndësishme arkitektonike dhe funksionale e ndërtesës. Ato sigurojnë ndriçimin për pjesët e sipërfaqes së brendshme të tyre. Madhësia (kupto dimensionet) e tyre variojnë, varet nga kompozimi arkitektonik, nga madhësia e sipërfaqes së brendshme dhe kërkesat e tjera të projektuesit. Dritaret duhet të jenë në kuotë 80-90 cm mbi nivelin e dyshemesë, kjo varet dhe nga kërkesat e projektuesit. Dritaret mund të jenë të prodhuara me alumini. Pjesët kryesore të dritareve janë: Kasa e dritares që fiksohet në mur me elemente prej hekuri përpara suvatimit. Korniza e dritares do të vidhohet me kasën e saj mbas suvatimit dhe bojatisjes. Në bazë të vizatimit të dritares së treguar në vizatimin teknik, korniza do të pajiset në kasë me mentesha dhe bllokues të tipeve të ndryshme të instaluar në te. Kanate me xhama të hapshëm, të pajisur me mentesha, doreza të fiksuara dhe me ngjitës transparent silikoni, si dhe me kanata fikse.

### 5.3 F. V. dritare duroplasti dopjo xham

Dritare duralumini Furnizimi dhe vendosja e dritareve, siç përshkruhet në specifikimet teknike me dimensione të dhëna nga kontraktori, përbëhen nga material alumini, profilet e të cilit janë sipas standarteve Europiane EN 573-3 dhe janë profile të lyera përpara se të vendosen në objekt. Ngjyra

e dritares do të jetë sipas kërkesës së investitorit. Korniza fikse e dritare do të ketë një dimension 61-90mm. Ato janë të siguruar me elemente që shërbejnë për vendosjen dhe ankorimin në strukturat e murit, si dhe me pjesët e dala që shërbejnë për rrëshqitjen e skeletit të dritares. Forma e profilit është tubolare me qëllim që të mbledhë gjithë aksesorët e saj. Profili i kanates të dritares do të jetë me dimensione të tilla 25 mm që do të mbulohet nga profili kryesor që do të fiksohet në mur. Profilet e kornizave të lëvizshme kanë një dimension: gjërësia 32 mm dhe lartësia 75 mm të sheshta ose me zgjedhje ornamentale. Të dyja korniza fikse ose të lëvizshme janë projektuar dhe janë bërë me dy profile alumini të cilat janë bashkuar me njëra tjetrën dhe kanë një fugë ajri që shërben si thyerje termike, ato janë të izoluara nga një material plastik 15 mm. Profilet e aluminit do të jenë të lyera sipas procesit të pjekjes lacquering. Temperatura e pjekjes nuk duhet të kalojë 180 gradë, dhe koha e pjekjes do të jetë më pak se 15 minuta. Trashësia e lacquering duhet të jetë së paku 45 mm. Pudrosja e përdorur do të bëhet me resins acrylic te cilesisë së larte ose me polyesters linear. Spesori i duraluminit duhet të jetë minimumi 1,5 mm. Panelet e xhamit (4mm të trasha kur xhami është transparent dhe 6 mm të trasha kur janë të përforcuara me rrjet teli ose me dopio xham). Ato do të jenë të fiksuara në skeletin metalik me anë të listelave të aluminit në profilet metalike të dritares dhe të shoqëruara me gomina. Të gjitha punët e lidhura me muraturen dhe të gjitha kërkesat e tjera për kompletimin e punës duhet të bëhen me kujdes. Një model i materialeve të propozuara do të shqyrtohet nga supervizori për një aprovim paraprak.

#### 5.4 Heqje dritare ekzistuese

Heqje dyersh dhe dritaresh, që realizohet para prishjes së murit, duke përfshirë kasën, telajot, etj Sistemimin e materialit që ekziston brenda ambientit të kantiërit. dhe grumbullimin në një vend të caktuar në kantier për ripërdorim.

#### 5.5 Heqje parrake metalik.

Heqje elemente metalike nga fasada e objektit (korrivano parapeti) Këta elementë janë të vendosur në objekt nga përdoruesit e objektit gjatë gjithë viteve të përdorimit. Për këtë arsye heqja e tyre duhet të bëhet me kujdes për të mos I dëmtuar më tej elementët e dekorit ose vetë muraturën. Heqja e këtyre elementëve është përlllogaritur të bëhet në një kohë shumë të shkurtër.

### 6. Punime bojatisje

#### 6.1 Boje hidroplastike

Boje hidroplastike Në fillim bëhet përgatitja e përzierjes së bojës hidromat të lëngët e cila është e pakeluar në kuti 5 – 15 litërshe. Lëngu I bojës hollonhet me ujë në masën 20-30 %. Kësaj përzierje I hidhet pigmenti deri sa të merret ngjyra e dëshiruar dhe e aprovuar nga Supervizori I punimeve dhe pastaj bëhet lyerja e sipërfaqes. Lyerja bëhet me dy duar. Norma e përdorimit është 1 litër bojë hidromat I holluar duhet të përdoret për 2.7 – 3 m<sup>2</sup> sipërfaqe. Kjo normë varet nga ashpërsia e

sipërfaqes dhe lloji I bojës së mëparshme. Në ndërtime të reja para lyerjes duhet të bëhet pastrimi I sipërfaqes që do të lyhet nga pluhurat dhe të shikohen dëmtimet e vogla të saj, të bëhet mbushja e gropave të vogla apo dëmtimeve të sipërfaqes së murit me anë të stukimit me material sintetik dhe bërja gati për lyerje. Para lyerjes duhet të bëhet mbrojtja e sipërfaqeve që nuk do të lyhen (dyer, dritare, etj) me anë të vendosjes së letrave mbrojtëse. Në fillim të procesit të lyerjes bëhet paralyerja e sipërfaqeve të pastruara mirë me gëlqere të holluar (Astari). Në fillim bëhet përgatitja e astarit duke përzier 1 kg gëlqere me 1 litër ujë. Me përzierjen e përgatitur bëhet paralyerja e sipërfaqes vetëm me një dorë. Norma e përdorimit është 1 litër gëlqere e holluar duhet të përdoret për 2 m<sup>2</sup> sipërfaqe. Më pas vazhdohet me lyerjen me bojë si më poshtë: -Bëhet përgatitja e përzierjes së bojës hidromat të lëngshëm me ujë. Lëngu I bojës hollonhet me ujë në masën 20 – 30 %. Kësaj përzierje I hidhet pigment derisa të merret ngjyra e dëshiruar. - Bëhet lyerja e sipërfaqes. Lyerja bëhet me dy duar. Norma e përdorimit është 1 litër bojë hidromat I holluar në 2.7 – 3 m<sup>2</sup> sipërfaqe (në varësi të ashpërsisë së sipërfaqes së lyer).

## 6.2 Parapet shkalle inoksi h=80-90cm.

Korimanot metalike Korimanot në ndërtime kanë funksione të ndryshme për të plotësuar. Ata duhet të ofrojnë mbrojtje dhe siguri gjatë të ecurit në shkallë. Po ashtu, korimanot luajnë një rol të veçantë në pamjen dhe bukurinë arkitektonike të një ndërtimi. Duhet që korimonat të jenë të larta 90 cm. Në raste kur gjatësia e shkallëve është më e madhe se 12 m korimonat duhet të jenë 90 cm të larta. Masa prej 80/90 cm varet edhe prej sipërfaqes të sheshpushimit. Korimanot montohen në shkallë ose anash shkallëve, të fiksuara mirë që të garantohet stabiliteti dhe qëndrueshmëria e tyre. Korimanot ose duhen mbuluar me elemente druri mund të sigurohen me ristela prej druri ose metali. Listelat ndërmjet tyre duhet të jenë më pak se 12 cm. Në rastet kur shkallët janë më të gjëra se 100 cm, atëherë duhet që përveç korimaneve, vendosen në muret e anës tjetër të shkallëve, parmakë për të siguruar një ecje të sigurt. Parmakët nëpër shkallë nuk duhet të jenë më të ulëta se 75 cm dhe jo më të larta se 90 cm. Kur flitet për shkollë ata të vendosen në një lartësi prej 80 cm. Parmakët duhen larguar nga muret min. 4 cm. Parmakët, preferohet të vendosen prej një materiali dhe forme të tillë, që prekja e tyre të jetë e lehtë dhe pa dëmtime. Preferohet që parmakët të prodhohen prej druri, sepse parmakët prej çeliku të lenë një përshtypje të ftohtë.



### 6.3 Boje hidroplastike cilesi e larte.

Boja për fasada është një boje, e cila duhet të jetë për përdorim të jashtëm me rezistencë ndaj agjentëve atmosferikë. Të jetë e përshtatshme për sipërfaqe të re apo të vjetër si suva, beton, etj. dhe të ketë shkallë të lartë mbulimi. **KARAKTERISTIKAT TEKNIKE:** - Natyra e lidhësit: Kopolimer (rezinë) akriliku - Viskoziteti:  $30000 \pm 3000$  cPs në 250 C - Tharja : 4-10 ore - Mbulimi :  $>12Mq /$  Liter - Peshë specifike : 1 Liter=1,6 + 10% Kg - Hollimi: 10-30% me ujë - Pamja estetike : Mat, pa shkëlqim - Ngjyrat në dispozicion : E bardhë dhe sipas katalogut RAL (RAL 4008, RAL 3000, RAL 5017, RAL 1003, RAL 6010, RAL 9017, RAL 1032). - Magazinimi : Në temperatura në intervalin + 50 C - 300 C - Jetëgjatësia : jo më pak se 2 (dy) vjet - Paketimi : Në konfeksion 5-15 Liter **STANDARTET QE PERMBUSH:** - ISO 16000-9 ose ekuivalente, lidhur me emetimin e komponenteve organike të paqendrueshem (VOC), ku emetimi të jete jo më poshtë se KLASA “A+”, si dhe T.V.O.C

### 6.4 Boje vaji sipërfaqeve metalike

Mbulesat ekzistuese e fasadave të jashtme janë me elemente metalik



Stukim dhe zmerilim të elementeve prej hekuri duke përdorur stuko të përshtatshme për përgatitjen e sipërfaqeve për lyerjen me bojë vaji.

Lyerje e elementeve prej hekuri, me bojë të përgatitur fillimisht me një dorë minio plumbi ose antiruxho ose në formën e vajit sintetik, me dozim per m<sup>2</sup>, 0.080 kg.

Lyerje me bojë vaji sintetik për sipërfaqe metalike, me dozim per m<sup>2</sup>: bojë vaji 0.2 kg dhe me shumë duar për të patur një mbulim të plotë dhe perfekt të sipërfaqeve si dhe çdo gjë të nevojshme për mbarimin e plotë të lyerjes me bojë vaji në mënyrë perfekte.

Kërkohet mendim i projektuesve mbi përcaktimin e ngjyrave të fasadës gjatë zbatimit të punimeve.

## 7. Punime tavani dhe suvatimi.

### 7.1 Veshje me pllaka majolike.

Veshje me pllaka majolike ne tualete, veshje Muri ne pjesen e lavamanit ne muret e tualeteve do te vishen me pllaka. Përsa i takon ngjitjes të pllakave të tipeve të ndryshme me llaç, duhet që punimet t'u permbahen këtyre kushteve: Baza në të cilën ngjiten pllakat e tipeve të ndryshme, duhet të jetë e pastër nga pluhuri dhe të jetë e qëndrueshme. Përbërja e llaçit është e njëjta siç është e përshkruar më lart në pikën 6.2.1. Trashësia e llaçit duhet të jetë jo më pak se 15 mm. Ngjitja e pllakave me kollë, bëhet kur sipërfaqja e bazës mbajtëse është e drejtë. Kollu vendoset sipas nevojës me një trashësi prej 3 mm deri në 15 mm. Të gjitha kriteret e lartpërmendura, të cilat duhet t'i plotësojë llaçi, vlejne edhe për kollin. Mbasi të thahet llaçi ose kollu, duhet që fugat e planifikuara, të mbushen me një material të posaçëm (bojak). Fugat nëpër qoshe dhe lidhje të mureve duhet të mbushen me ndonjë masë elastike (si psh silikon). Për secilën sipërfaqe 20 m<sup>2</sup> të veshur me pllaka të ndryshme, është e nevojshme vendosja e fugave lëvizëse.

### 7.2 Plintuese grez h=10cm.

Plintuse grez importi ,h=10cm do te konsistojne ne: Blerjen e plintuseve grez dhe kolles dhe montimin e tyre ne objekt.

### 7.3 Patinimi,Suvatim

Patinurë muri realizohet me stuko, çimento dhe me gëlqere të cilësisë së lartë, mbi sipërfaqe të suvuara më parë dhe të niveluara, me përmbajtje: gëlqere 3 kg për m<sup>2</sup>. Lartësia e patinurave për ambientet e ndryshme të ndërtesës duhet të vendoset nga Supervizori, përfshirë dhe çdo punë tjetër dhe kërkesë për ta konsideruar patinurën të përfunduar dhe të gatshme për tu lyer me çdo lloj boje.

### 7.4 Suvatim i jashtëm në rikonstruksione

Stukim dhe sistemim i sipërfaqeve ku është e nevojshme, për suvatime për nivelimet e parregullsive, me anë të mbushjes me llaç bastard me më shumë shtresa dhe copa tullash n.q.s është e nevojshme, edhe për zonat e vogla si dhe çdo detyrim tjetër për ta përfunduar plotësisht stukimin.

Përpara se të hidhet sprucimi duhet që/ sipërfaqja që do të suvatohet të laget mirë me ujë. Sprucim i mureve dhe tavaneve për muraturë të pastruar me llaç çimentoje të lëngët për përmirësimin e ngjitjes së suvasë dhe rforcimin e sipërfaqeve të muraturës, duke përfshirë skelat e shërbimit dhe çdo detyrim tjetër për ta përfunduar plotësisht sprucimin.

Suvatim i realizuar nga një shtresë me trashësi 2 cm llaçi bastard m-25 me dozim për m<sup>2</sup>: rërë e larë

0,005 m<sup>3</sup>; llaç bastard 0.03 m<sup>3</sup>; çimento 400, 7.7 kg; ujë, i aplikuar me paravendosje të drejtuesve në mure (shirtit me llaç me trashësi 15 cm çdo 1 deri në 1,5 m ), dhe e lëmuar

me mistri e bërëdraf, duke përfshirë skelat e shërbimit si dhe çdo detyrim tjetër për ta përfunduar plotësisht suvatimin.

## **8.Punime shtresash.**

### **8.1.Shtrim me llustër çimento**

Shtresa me llaç çimentoje 2 : 1 me trashësi minimale 2 cm, duhet lëmuar dhe sheshuar në mënyrë perfekte, duke përfshirë kallëpet, përforcimet, si dhe çdo detyrim tjetër për mbarimin e punës me cilësi.

### **8.2 Shkalle montazhi mermer.**

Shkallë betoni veshur me mermer Për veshjen e shkallëve të betonit me mermer duhet të parashikohen këto punë: Në fillim duhet që shkallët e betonit të pastrohen mirë si dhe të rrafshohet vendi. Pastaj duhet që shkalla prej betoni të lyhet me qumësht çimentoje, i cili e lehtëson ngjitjen e pllakave të mermerit. Ngjitja e pllakave të mermerit bëhet ose duke përdorur llaç ose në rast se shkallët e betonit janë të rrafshta, atëherë mundet që këto të ngjiten edhe me kollë. Ngjitja e pllakave të mermerit nuk ndryshon nga ngjitja e pllakave në mur, pikë e cila është përshkruar gjerësisht në 6.1.14.

## **9.Instalime hidrosanitare.**

### **9. Bolier**

Uji i ngrohte sanitar është i kompozuar të realizohet prej prodhuesit të energjisë termike që në rastin tonë do të jenë boilerat elektrike si dhe tubacioneve të pajisjeve të tjera për furnizimin dhe rregullimin e tij. Boiler elektrik ( shkëmbyesi i nxehtësisë ) Prodhuar i ujit të ngrohte sanitar është përzgjedhur për të siguruar furnizim gjatë gjithë ditës. Madhësia e tij është kalkuluar në funksion të nevojave për ujë sanitar dhe karakteristikat e tij duhet të jenë përcaktuar qartë në certifikatën e kualitetit të lëshuar nga prodhuesi. Karakteristikat teknike kryesore janë praqitur këtu me poshtë: Tipi : Boiler horizontal i termoizoluar me shkëmbyes inoksi të zmontueshëm; Izolimi : Shtresë fleksibile shkume polyuretani 50 mm trashësi; Veshja e jashtme : Çeliku me karbon, i mbrojtur me një shtresë epoxidi në ngjyrë të bardhë e polimerizuar; Mbrojtja : Sistemi i mbrojtjes katodike, anode magnezit dhe thjeshtë; Kapaciteti : 12 – 60 lit, Pmax 8 bar, Tmax 95 0C; Kondita e punës : Pmax 8 bar, Tmax 95 0C.

## 10.Instalime per ndricim.

### 10.1 Priza shuko

- Priza shuko: 220V, 16A dhe bivalente: 220, 10A. Me frute – modulare per ambiente rezidenciale



### 10.2 Celes 1 polar

Celes 1, deviator, invertitor, etj: 220V, 10A, me frute-module per ambiente rezidenciale.  
Butona220,10A per komandimin e grilave, zile, ndricim, etj.  
Ngjyra dhe lloji perfundimtar te zgjidhet sipas rekomandimeve te arkitektures.

### 10.3 Llampat flureshente

Llampat.

Të gjithë ndriçuesit neonë duhet të jenë të tipit me katodë të nxehtë, përjashtojt zonat ku tensioni nuk sigurohet.

Për përdorim të përgjithshëm karakteristikat janë si më poshtë dhe gjithë llampat duhet të kenë produkte të barabarta me ato në tabelë.Gjith llampat duhet të kenë ngjyra të njëjta,duhet të jenë

të paketuara në zarfe vëllimesh jo më pak se sa janë kërkuar nga tabela e mëposhtme:

Karakteristikat

Gjatësia nominale mm	Ëëattazhi (Ëëatt)	Fluksi i ndriçimit pas 2000 orësh	Ngjyra temp	Diametri i llampës mm
1500	58	4500	E bardhë	26
1200	36	2800	3600	26
600	18	1100	Degrees	26
300	8	420	K	26

Pajisjae kontrollit.

Pajisja e kontrollit për llampat floreshente duhet të jetë me qark inxhinerik tipit droesel me injeksion induktiv elektronik për të minimizuar humbjet, të cilat nuk duhet të kalojë 8 ëatt për një gjatësi llampe 1200mm dhe 10 ëatt për gjatësi llampe 1500 mm .

Ndezja elektronike duhet të jetë asimetrike në aplikim duke shmangur mundësinë e saturimit që rezulton në rastin e korentit të lartë në start.

Apajisjet dhe karakteristikat e shpërndarjes së ndriçimit të ndriçuesve neon duhet të përputhen

me informacionin e dhënë në skicë. Të gjithë ndriçuesit fluoreshentë duhet të jenë të pajisur me një faktor korigjimi fuqie që duhet të korigjojë faktorin e fuqisë jo më pak se 0.9lagging..Çinteti

harmonik brenda qarkut të llampës nuk duhet të kalojë 17%.

Abazhuret dhe pajisjet e tjera ndihmëse duhet të jenë në përputhje me C.E.E 12 dhe çdo përshtatje duhet të bëhet me fishek siguresë në ingranazhin e konpartmentit të graduar jo më shumë se 5 amper.

Ndriçuesit neonët dhe pajisjet ndihmëse të prodhuara nga ose nga firma të tjera të ngjashme si më poshtë .

Tipi 884EL compact, FLC 2x18 D/E, difuzor i qelqtë, ndezje elektronike, ngjyrë e bardhë. Tipi 784 El compact, FLC2x18 D/E, difuzor i qelqtë, ndezje elektronike, ngjyrë e bardhë .

Tipi 891Attiva 60 °, FLC 2x18 L, difuzor lamelar, i errët1, ngjyrë e bardhë

Tipi 791,Attiva 60 °, FLC2x18L, difuzor lamelar, i errët1,ngjyrë e bardhë . Tipi 874 EL Comfort 60 °, FL 4x18, difuzor lamelar i errët1, ngjyrë e bardhë.

Tipi 814 Comfort, FL2x36, difuzor prizmatik, ngjyrë e bardhë .

Tipi 971EL HYDRO, FL 1x36 ose FL 2x36 fabrikuar me polikarbonat rezistent, difuzor transparent prizmatik, ngjyrë gri.

Tipi 1544 globo, FLC 2x13D, polikarbonati difuzor, ngjyrë e bardhë.

Ato duhen prodhuar nga fletë të mbuluara me xink ose me fletë çeliku të ngjashme dhe duhen mbërthyer për të formuar një njësi të ngurtë. Lyerja me bojë duhet të jetë e një cilësie të lartë për të. Çdo gërryerje e pjesëve metalike të neonëve duhet ndjekur menjëherë nga një trajtim me kromat zinku i anëve të papërpunuara dhe të lyer me bojë zalti sintetike me ngjyrë të bardhë.

Deri kur të detajohen në një mënyrë tjetër, ato duhen fiksuar drejt në kutitë hyrëse të kabllove ose linjën e ndriçimit e duhen pasur kujdes për t'u siguruar që ato janë të sigurt aq sa të pranojnë peshën e neonëve.

Ndriçuesit montohen kur të kenë përfunduar të gjitha punimet e ndërtimit dhe të lyerjes. Dëmtimi i neonëve dhe në veçanti dëmtimi nga ndryshku, vjen si rezultat i montimit të parakohshëm. Në

raste të tilla supervizori mund të kërkojë heqjen dhe zëvendësimin pa kosto për punëdhësin.

Pajisjet e kontrollit dhe pajisjet e tjera ndihmëse, duhet të dislokohen brenda çdo njësie për të lejuar përhapjen e nxehtësisë brenda limiteve të tyre të temperaturës.

Çdo ndriçues duhet të ketë një bllok konektori të fiksuar për të dalluar qartë kabllo të hyrëse të fazës, nulit dhe tokës. Ky bllok konektori duhet të ketë përmasa të



tilla që brenda tij të përfshihen kabllot me 2.5 mm<sup>2</sup> në çdo konektor. Faza e çdo neoni duhet të ketë një siguresë të përshtatshme dhe që mund të ndërrohet pa probleme.


Në figurat e mëposhtme paraqiten disa tipe të ndryshme llampash:



Ndriçuesa për ambiente me lagështirë.

#### 10.4 Ndricues me spot

Ndricues Fluoreshent Tavanor i tipit Industrial me llampe te tipit T8, 2x36Ë G13, FD 89lm/ë, IP 65, stampa CQS/IQNET. Klasa II, izolim i dyfisht.



### 10.5 F.V Tuba

Tuba rigid dhe aksesore per instalimin e tyre me material izolues dhe veteshuares PVC në përputhje me kërkesat e AS 2053.2 per instalime ne tavanin e varur dhe parking. Rezistent ndaj vjeterimit dheujit. Struktura rigid, i forte dhe i qendrueshem ne instalim. Instalimi ne ambiente deri ne 70C. Certifikuar CE,ROHS, GTS.

## 11.Punime hidroizolimi dhe catite.

### 11.1 Ulluqet horizontal

Realizohen me pjerrësi prej 1% për largimin e ujrave. Ulluqet horizontale prodhohen me material plastik ose me llamarinë xingato. Ulluku me llamarinë prej çeliku të xinguar me trashësi jo më të vogël se 0,8 mm, i formuar nga pjesë të modeluara me mbivendosje minimale 5 cm, të salduara në mënyrë të rregullt me kallaj, me bord të jashtëm 2 cm më të ulët se bordi i brendshëm, të kompletuara me pjesë speciale për grykën e hyrjes. Ulluku horizontal, i modeluar sipas udhëzimeve në projekt, duhet të jetë i lidhur me tel xingato me hallka të forta të vëna maksimumi në 70 cm. Në objektet me taracë përdoren edhe ulluqe betoni. Të gjitha ulluqet prej betoni duhet të hidroizolohen me guaino nga ana e brendshme e tyre. Ulluket e vendosura ndërmjet çatise dhe parapetit do të jenë prej llamarine të xinguar, sipas detajeve të vizatimit.

### 11.2 Ulluqet vertical

Janë për shkarkimin e ujrave të çatave dhe taracave, dhe kur janë në gjendje jo të mirë duhet të çmontohen dhe të zëvendësohen me ullukë të rinj.

Ulluqet vertikale për shkarkimin e ujrave të çatave dhe taracave që përgatiten me llamarinë prej çeliku të xinguar, duhet të kenë trashësi jo më të vogël se 0.6 mm dhe diametër 10 cm, kurse ulluqet vertikale prej PVC kanë dimensione nga 8 deri në 12 cm dhe mbulojnë një sipërfaqe çatie nga 30 deri në 60 m<sup>2</sup>.

Në çdo ulluk duhet të mblidhen ujrata e një sipërfaqe çatie ose tarace jo më të madhe se 60 .

Ulukët duhet të vendosen në pjesën e jashtme të ndërtesës, me anë të qaforeve përkatëse prej çeliku të xinguar, të fiksuar çdo 2 m. Ujrat e taracës që do të kalojnë në tubat vertikale duhet të mblidhen nëpërmjet një pjate prej llamarine të xinguar, i riveshur me guainë të vendosur në flakë, me trashësi 3 mm, të vendosur në mënyrë të tërthortë, ndërmjet muraturës dhe parapetit, me pjerrësi 1%, e cila lidhet me kasetën e shkarkimit sipas udhëzimeve në projekt.

Pjesa fundore e ulluqeve, për lartësinë 2 m, duhet të jetë PVC dhe e mbërthyer fort me ganxha hekuri si dhe poshtë duhet të kthehet me bërryl 90 gradë.

## 12. Analize jashte liste

### 12.1 F.V. Kabell

Të gjitha telat dhe kabllot duhet të kenë çertifikatën e aprovimit të autoriteteve lokale përkatëse dhe çertifikatën e fabrikës.

Telat duhet të jenë përçues të thjeshtë bakri të izoluara (veshura) me shtresë teke PVC për tu futur brenda tubave dhe linjave.

Izolimi i telave dhe këllëfi duhet të jenë me izolim të ngjyrosur për të identifikuar fazën dhe nulin. Të gjitha rastet kur kabllot PVC përfundojnë në një panel shpërndarës siguresash, pajisje

elektrike etj, duhet lënë një sasi kabli të lirshëm për të lejuar në të ardhmen, zhveshjen e

rilidhjes me terminallet pa shkaktuar tërheqje të tyre.

Kabllot për çdo seksion të instalimit duhet të mbyllen nëpër tuba dhe në sistemin e kutive futëse përmbledhëse për atë ndarje të veçantë. Kabllot duhet të instalohen duke përdorur sistemin “lak”

Zhveshja e izolimit në kabllot e izoluara me PVC duhet të kryhet duke përdorur një vegël të përshtatshme për zhveshjen, dhe jo një thikë.

Telat duhet të jenë të ngjyrosura për identifikim. E zeza duhet të përdoret për përçuesit e neutrit, Jeshilja/e verdha duhet të përdoren për përçuesit e tokës dhe ngjyra e kuqe/blu dhe e verdhë për përçuesit fazë. Të njëjtat ngjyra duhet të përdoren për lidhjet në të njëjtët përçues fazë. Të njëjtat ngjyra duhet të përdoren për lidhjet në të njëjtën fazë furnizimi për të gjithë instalimet.

Të gjitha kabllot tek duhet të vendosen në mënyrë të tillë që të kenë në anë etiketën dhe vulën e prodhuesit ose prova të tjera të origjinës dhe kontraktuesi duhet të marrë çertifikatat e testeve të përhershme të prodhuesit kundrejt një urdhri të dhënë, n.q.s kërkohet nga inxhinieri.

Numri i kabllave që duhen instaluar në tuba duhet të jetë aq sa të lejojë futjen e lehtë pa dëme të kabllave dhe nuk duhet të zërë në asnjë rrethanë më shumë se 40% të hapësirës. Instalimi duhet të përputhet me KTZ në Shqipëri.

### 12.2 F.V kabell FG

Kablllo fleksibël (me disa tela shumëfijësh për çdo tel) Të gjitha kabllot duhet të kenë çertifikatën e aprovimit të autoriteteve lokale përkatëse dhe çertifikatën e fabrikës. Izolimi PVC i kabllave duhet të durojë 600/1000 V, shumëtelësh ose me tel tek me përçues të thjeshtë prej bakri të temperuar të izoluar me PVC dhe me një këllëf PVC je përfundimtar të sipërm. Të gjithë kabllot e futur nëpër tuba duhet të jenë të izoluar me polivinil klorid dhe me përçueshmëri të lartë. Kabllot fleksibël janë të përbërë nga tela shumëfijësh dhe në varësi të tyre kemi: • Kablllo me 3 tela, 1 fazë, 1 nul, 1 toka (për sistemin njëfazor) • Kablllo me 4 tela, 3 Faza dhe 1 nul (për sistemin trefazor pa tokëzim) • Kablllo me 5 tela, 3 faza, 1 nul dhe 1 toka (përsistemin trefazor me tokëzim) Kabllot fleksibël duhet ti kenë telat të ngjyrosura për identifikim. E zeza duhet të përdoret për përçuesit e neutrit, Jeshilja/e verdha duhet të përdoren për përçuesit e tokës dhe ngjyra e kuqe/blu dhe e verdhë për përçuesit fazë. Të njëjtat ngjyra duhet të përdoren për lidhjet në të njëjtët përçues fazë. Të njëjtat ngjyra duhet të përdoren për lidhjet në të njëjtën fazë furnizimi për të gjithë instalimet. Asnjë kabëll me seksion më të vogël se 2.5 mm<sup>2</sup> s' duhet të përdoret me instalim vetëm nëse përmendet në veçanti. Përçuesit e tokës duhet të kenë një masë minimale të kërkuar nga rregullorja.

### 12.3 Shtrim me pllaka guri

Shtrim me pllaka guri. Pllaka guri me trashësi që e përcakton investitori dhe supervizori të vendosura mbi shtresë rere si dhe çdo detyrim tjetër dhe mjeshteri për mbarimin e punës në mënyrë perfekte. Pllaka të zgjidhet nga perfaqësuesi i sipërmarrësit, nga supervizori dhe perfaqësuesi i Bashkisë. (çështje, dimensionet dhe ngjyra esaj).

## 13. Pajisje jashte liste.

### 13.1 Raketa ping pong.

Pro Touch Pro 2000 është një raketë ping pongu e përshtatshme për lojtarë që e kanë këtë sport si hobi që të luajnë me familjen dhe miqtë. Është prej druri dhe sipërfaqja është e mbuluar me gomë të kuqe dhe të zezë për kapje më të mirë.

- Dorezë prej druri
- Mbulesë gome me kapje shumë të mirë
- Kontrolli: 70
- Shpejtësia: 40
- Rrotullimi: 40

### 13.2 Top ping pong

A40 + me 3 yje është topi më i ri plastik i ping pongut të Butterfly. Këta janë topa profesionistë të ping pongut të miratuar nga Federata Ndërkombëtare e Ping pongut (ITTF) dhe USTTA për lojërë në turne të nivelit të lartë. Topat A40 + kanë përmasa rregulluese (40 mm) dhe janë shumë të rrumbullakët, të karakterizuar nga e njëjta trashësi në të gjitha pikat. Kjo krijon një kërcim shumë të qëndrueshëm që mund të vlerësohet nga lojtarët e ping pongut të të gjitha niveleve.

- Përmasat: 30 x 20 x 10 cm
- Pesha: 310 g
- Material plastik

### 13.3 Tavoline bilardo



Tavolina e Bilardos do të jetë kryesieshte e përbërë prej drurit. Dimensionet e biliardos janë 200 x 100 x 80 cm. Ajo do të pozicionohet në katin perdue në zonën e lojrave të tavolinës.

### 13.4 Steka bilardo

Stekat e bilardos do te jene kryesishte perberje druri.Dimensionet e stekes do te jene 150cm.

### 13.5 Tavoline futboll (bilardino)



Dimensionet 60 x 180 x 45 cm

#### Tavoline loje me futboll

Tavolinë loje e bërë nga druri dhe materiale të cilësisë së lartë. Është e palosshme dhe e lehtë për t'u ruajtur, kështu që hapësira nuk është kurrë problem. Në pjesën e sipërme mundëson futboll klasik tavoline dhe, kur hiqet kjo pjesë, zbulohet loja e bilardos amerikane. Të gjithë aksesorët janë të përfshirë, edhe çanta prej pëlhure për të ruajtur topat që të mos humbasin.

Dhurata perfekte për të shijuar lojë dhe argëtim në familje

E palosshme për të zënë shumë pak hapësirë ruajtëse.Bërë nga druri i cilësisë së lartë

### 13.6 Kavalet pikturë



Dimensionet: 50 x 20x 90 cm

Kavaleta do të pozicionohet në zonën e pictures në katin përdhe.Ajo është prej druri.

### 13.7 Ndenjese puff.



Ndenjese puff i mbushur (kokriza buke peshku) dimensioned e tij jane 90 cm. lartesia 65cm. Ngjyrat mund te jene te zeza dhe te kuqe.

### 13.8 Ndenjese statike.



Ndenjësa statike do të pozicionohet ne katin përdhe dhe do të shërbeje për zonën çlodhese të zonave të lojrave në tavolinë.

Nje pjese e saj këmbet dhe struktura do të jenë druri dhe metalike. Pjesa tjetër do të jetë tekstile e mbeshtjelle me sfunxher.dhe cope të fortë dhe cilësore mbi të. E rëndësishme që ky material të lahet e të pastrohet lehte. Kërkohe që nngjyra e tyre të jetë e kuqe.

### 13.9 Karrige zyre.

Shpina dhe ulesja te jene te bera me plastike



te zeze, rezistente ndaj goditjeve, te mbushura me sfungjer te cilesise se larte me dendesi 40kg/m<sup>3</sup>, i ngjitur me lende ngjitese, per te krijuar formen ergonomike, dhe te veshura me tekstil (tapiceri).

o Pjesa e poshtme e uleses dhe e pasme e shpinores mbulohen me kapak plastik te se njejtës forme. Permasat e uleses te jene: 450x400m, ndersa te shpinores te jene 300x450 mm.

- Lartesia e uleses dhe shpinores te j ene perkatesisht 400-460mm dhe 700-750 mm.

Struktura mbajtese te j ete e perbere prej profil celiku oval me permasa.

#### 14. Tavoline zyre 69 x 160 x 75 cm



- Lartësia: 75 cm
- Thellësia: 69 cm
- Materiali: Melaminë
- Ngjyra: Lisi
- Gjerësia: 160 cm

Tavolina do të ketë finiturë lisi me dimensioned e mesipërme. Materiali do të jetë melamin. Dizenjimi kompakt përfshin të gjithë hapësirën që ju nevojitet për një tavolinë të mirë-organizuar si me pajisjet kompiuterike.

#### 14.1 Tavoline mbledhjeje 100 x 262 x 75cm



Tavolina duhet të jetë me syprinë dimensioned e të cilës duhet të jenë 100 x 262 cm dhe lartësi 75 cm. Syprina duhet të jetë MDF me ngjyrë lisi. Këmbët e tavolinës duhet të jenë metalike të zeza.

#### 14.2 Mobilje me dollap.

Mobilja duhet të jetë rezistente ndaj peshave, goditjeve, gervishtjeve, qendrueshmerise dhe stabilitetit, njollave, dizinfektanteve etj. Skeleti dhe kanatet dhe Sergjenët do jenë prej materiali MDF 1.6 cm me lyerje ngjyre druri sipas kodeve të perzgjedhura në kordinim me autoritetin kontraktor. Xokola dhe korniza përreth do jenë 5 cm e lartë dhe prej të njëjtit material. Bordet anësore të skeletit dhe kanateve të jenë të rrethuara me material plastik PVC. Dorezat e kanateve dhe aksesoret e përdorur të jenë cilësorë. Montimi dhe zmontimi të jenë sa më i thjeshtë. Të paktohen që të mos dëmtohen gjatë transportit.





#### 14.3 Tavoline trekendeshi 145x150x75 cm

Ngjyra: E Bardhë/Kafe

- Materiali i strukturës: Strukturë Melamin
- Përmasat 145x150x75



#### 14.4 Kolltuk kinaje lounge.



#### 14.5 Ekran kinemaje (Home cinema), TV + audio

Video prjektor me sistem motorri I pershtatshme per salla Home theatre. Ka nje dizanj te sofistikuar dhe garanton mundesine e krijimit ten je kinemaje ne ambiente me te vogla.

Paneli ku do te prjektohet fiksohet ne tavan dhe muri gjithashtu.

| Ultra HD 4K | 400 Hz | DVB-T2 | Dolby Surround | I cili do te fiksohet me ne mur.



**ELLIPSE HOME CINEMA** è uno schermo per video-proiezione motorizzato adatto ad applicazioni in salotto Home Theatre. Il design assolutamente raffinato ed innovativo del cassonetto, permette una grande versatilità ed adattabilità a svariati contesti domestici, garantendo la possibilità di riprodurre realisticamente il cinema in casa. È dotato di serie di bordi laterali neri, bordo inferiore nero contrappeso nero in alluminio ed extra drop nero alto 30 cm.

Disponibile in formato 4:3, 16:10, 16:9 e su misura.



Particolare caduta anteriore (optional)



Stile sottosopra



Interf. 1 telecomando salita/discesa



Telecomando con ricevitore esterno



Posto 2-voti



Installazione a parete



Comando di gravità





Intestaggia Rotata





Alm. 9 Rpm 26 Motore veloce



Alm. 7 Rpm 18 Motore con silenziosità



POSIZIONE CADUTA TELA STANDARD



**SPECIFICHE TECNICHE**

- Motorizzazione silenziosa e veloce
- Potenza: **6 Nm**
- Velocità: **17 rpm**
- Input: **230V / 50 Hz**
- Consumo: **137 W**
- Certificazione: **IMQ**
- Costruito interamente in alluminio
- Design raffinato e grande facilità di installazione
- Dimensioni del cassonetto: 105x109 mm. (PxH)
- Cassonetto verniciato con polveri epossidiche bianche (RAL 9010)
- Due staffe universali per l'ancoraggio a soffitto o a parete in dotazione
- Interruttore salita/discesa in dotazione
- Il cavo di alimentazione del motore esce dal lato **destra** del cassonetto, posizionandosi frontalmente rispetto allo schermo
- Superfici per proiezione ignifughe
- Bordi neri laterali larghi 5 cm, bordo inferiore nero alto 5 cm, abbassamento superiore nero alto 30 cm, e contrappeso nero: altezza 35 mm, profondità 20 mm.
- Cassonetto disponibile in diversi colori (optional)

OPZIONI SPECIFICHE IN MISURA CON ELLIPSE IN METAL

FORMATI E DIMENSIONI misure in cm				
Formato 4:3 Dimensioni (BxH)	Formato 16:10 Dimensioni (BxH)	Formato 16:9 Dimensioni (BxH)	Ingombri Massimi A - C	Peso Netto Indicativo (Kg)
160 x 120	160 x 109	160 x 90	179 - 174	15
180 x 135	180 x 112	180 x 101	199 - 194	16
200 x 150	200 x 125	200 x 112	219 - 214	18
220 x 165	220 x 137	220 x 124	239 - 234	20
250 x 190	250 x 155	250 x 140	269 - 264	23
300 x 225	300 x 187	300 x 169	319 - 314	28

TELE DISPONIBILI	
Tele proiezione frontale	Gli
White	1,2
Matte White	1,2
Lum Gray	0,8
Microperforated	1,1
Lum Gray Microperforated	0,8
Clearcoat	0,7
Pure KS	1,1
Pure Matte KS	1,1
Fibre Matte*	1,25

\* Misura altezza luce di proiezione limitata

Garanzia: 5 anni sul motore - 24 mesi suoli altri componenti

## 14.6 Kompjuter njesi.



- 14.4 Kompiuteri njesi
- 14.5 Ekran kompiuteri
- 14.6 Tastiere
- 14.7 Mouse Kompiuteri

<b>KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE</b>	
<b>Pikët Min. për Procesorin sipas: cpubenchmark.net Min Proc. Rating According to: cpubenchmark.net:</b>	7900 Pikë
<b>“RAM”:</b>	8 GB DDR4, min. 2666 MHz, Non-ECC
<b>Madhësia e Solid-state Drive “SSD Size”:</b>	500 GB SSD
<b>“Disk Subsystem Controller”:</b>	Serial ATA III 6 Gb/s
<b>Karta Grafike “Graphics”:</b>	Integrated graphic Card, min. 1 GB
<b>“Media Device”:</b>	DVD+/-RË
<b>“Slots”:</b>	Min. (3) PCI/PCI-E, nga të cilat min. (1) PCI-E 3.0 x16
<b>KOMUNIKIMI &amp; MENAXHIMI</b>	
<b>Portat e Komunikimit “Ports”:</b>	Min. (6) USB nga të cilat: a. Min. (2) USB Para; b. Min. (4) USB 3.0 (1) RJ-45, (1) Audio In/Out, (1) Mic. and (1) Headphone, (1) Portë DP/DVI/HDMI/VGA
<b>Rrjeti “Networking”:</b>	(1) 10/100/1000 LAN Integrated Gigabit Ethernet Port
<b>“Sound”:</b>	Integrated Sound Card
<b>“Speakers”:</b>	Internal or Built-in Monitor
<b>Siguria “Security Management”:</b>	Embedded Security TPM 2.0
<b>Sistemi i Operimit “Preinstalled Licensed O.S.”:</b>	OEM Ëindoës 10 64-bit Professional
<b>Tastiera “Keyboard”:</b>	Standart Keyboard QËERTY
<b>“Mouse”:</b>	Minimum 3 Button Scroll Optical
<b>Ushqimi “Poëer Supply”</b>	220 V AC, 50 Hz
<b>Kursimi i Energjisë “Energy Efficiency”:</b>	Energy Star
<b>AKSESORËT</b>	
<b>Kabëll “Poëer Cord”:</b>	Po, European
<b>“Recover”:</b>	Recover Partition
<b>MONITORI</b>	
<b>Tipi “Type”:</b>	LCD OSE LED i të njëjtës Markë me Kompjuterin
<b>Madhësia “Size”:</b>	≥ 21”

<b>Rezolucioni “Native Resolution”:</b>	1920 x 1080 at 60 Hz
<b>Raporti i Kontratit “Constrast Ratio Static”:</b>	1000:1
<b>“Display Port”:</b>	(1) VGA dhe të paktën (1) prej portave DP/DVI/HDMI
<b>Koha e Rifreskimit “Response Time”:</b>	≤ 6 ms
<b>Kursimi i Energjisë “Energy Efficency”:</b>	Energy Star
<b>Ushqimi “Poëer Supply”:</b>	220 V AC, 50 Hz
<b>GARANCIA</b>	
<b>Periudha e Mbulimit të Garancisë “Ëarranty”:</b>	3 Vjet

#### 14.8 Sistem audio kinemaje.



#### 14.9 Pasqyra murale.

Pasqyra është bërë me një brez të veçantë në anë melamine dhe është 100% Prodhuar në Itali . Ky produkt është i përshtatshëm për të kompletuar dekorimin e çdo zone ndenjeje falë përfundimeve të thjeshta dhe elegante që i japin dhomës një prekje unike dhe të paharrueshme. Materiali i përdorur garanton cilësi dhe rezistencë edhe me kalimin e kohës.

#### 15. Mikrofon podcast.

PodMic është një mikrofon dinamik me cilësi transmetimi i optimizuar për performancë të jashtëzakonshme në podcast, transmetim të drejtpërdrejtë dhe aplikacione të tjera të të folurit ose vokalit. Duke ofruar një tingull të pasur, me trup të plotë, me një filtër të brendshëm pop për

minimizimin e lëndëve plozive, mbajtëse të brendshme goditjeje për reduktimin e dridhjeve dhe një mbajtëse lëkundëse për pozicionim të lehtë, PodMic do ta çojë përmbajtjen tuaj në nivelin tjetër.



### 15.1 Kufje.



Kufjet do të shërbejnë gjatë intervistave apo podcasteve të ndryshme. Kufjet premtojnë një përvojë revolucionare të muzikës me anulimin aktiv të zhurmës.

### 15.2 Varrese rrobash.

Varese rrobash murale ASTOR CIV, 93x26xH71 cm, Melamine dhe MDF

- Thellësia: 26 cm
- Nevojitet montim: Po
- Ngjyra: Lisi/e bardhë
- Materiali: Melaminë
- Lartësia: 71 cm
- Gjerësia: 93 cm

Punoi: Ark. Edona Venxha

Ing. Kostandin Tasho

**DREJTOR I DPPKMK**

**Ndriçim HOXHA**

